

Kategoritë e Ndhmës Shoqërore.

- 1. NDIHMA EKONOMIKE**
- 2. SHËRBIMET SHOQËRORE**

1.Ndihma Ekonomike

a-Pagesa ne lek e familjeve me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura.

Aplikimi kryhet nga kryefamiljari dhe anëtarët madhorë të familjes, konfirmohet nga Institucionet që mbulojnë punësimin, bizneset, automjetet etj. kontrolli në familje kryhet nga administratorët shoqërorë, të cilët propozojnë listën e përfituesve për çdo muaj. Nga Drejtoria përpilohet Relacioni dhe projekt-vendimi, të cilat i propozohen Këshillit Bashkiak i cili merr Vendimin përkatës për miratim. Pagesa sipas borderove përkatëse kryhet nëpërmjet bankave dhe në njësitë e largëta nëpërmjet zyrave postare. Pagesat kryhen nga buxheti i shtetit dhe caktohen 3% e tij me fonde të Bashkisë për raste specifike me të njëjtën mënyrë pagese.

b-Pagesa e kategorive P.A.K.(persona me aftësi të kufizuar)

Punonjësit social përgatisin dosjen personale të personit përfitues me Vendimin e KMCAP dhe ndihmojnë në plotësimin e saj me fletë-drejtimin për në Kemp (në rast se aplikohet për herë të parë) dhe epikrizën për të rikomisionuarit si dhe dokumentat e identifikimit, pregatit borderotë përkatëse dhe rakordon me zyrën e financave duke ja propozuar Këshillit Bashkiak për vënie në dijeni gjatë marrjes së vendimit, duke kryer pagesat nëpërmjet Bankës përkatëse dhe në njësitë e largëta nëpërmjet zyrave postare.

c-Pagesë për personat me status Invalid Pune (shtese invaliditeti)

Punonjësit social përgatisin dosjen personale të personit përfitues me Vendimin e KMCAP i DRSSH, vërtetimin e pagesës dhe dokumentat e identitetit. Pagesat nëpërmjet Bankës përkatëse dhe , pregatit borderotë përkatëse dhe rakordon me zyrën e financave duke ja propozuar Këshillit Bashkiak për vënie në dijeni gjatë marrjes së vendimit, duke kryer pagesat nëpërmjet Bankës përkatëse dhe në njësitë e largëta nëpërmjet zyrave postare.

Për çdo administrator është detyrim paisja me vërtetim e pjesëtarëve të skemave të ndihmës me vërtetimet përkatëse për t'i paraqitur kryesisht tek mjeku, ose ISSH, për rata që nuk përfitojnë.

2.Shërbimet Sociale

a-Zyra e strehimit

Ofron zbatimin e projekteve sociale të strtehimit

- . **Banesa me kosto të ulët**
- . **Banesa me qerra sociale**
- . **Bonus strehimi** (nga fondet e Bashkisë apo edhe të MMSR)
- . **Truall të paisur me infrastrukturë**

Personat e pastrehë aplikojnë për strehim sipas projektit në zbatim dhe sipas kategorive me kriter të ardhurat (pa të ardhura, me të ardhura të ulta, me të ardhura të mesme)

Specialisti përkatës pret dhe orienton aplikantët, në plotësimin e dosjes me formularin e vetdeklarimit, dokumentat nga Zyra e Rregjistrimit të pasurive dhe dokumentat e identitetit. Kjo për fazën e parë të hapjes së dosjes dhe në vazhdim të dhënave financiare dhe kriteret specifike mbështetur edhe në varësi të projektit në vazhdim.

Për çdo vlerësim, në bashkëpunim edhe me punonjësit social përgatitet materiali për Komisionin e Strehimit i cili bën vlerësimin dhe renditjen e aplikantëve, ja kalon Komisionit të Çështjeve Sociale të Këshillit Bashkiak dhe përgatit relacionin shpjegues dhe project-vendimin i cili i propozohet për miratim Këshillit Bashkiak.

Për bonusin e strehimit merret kontrata e personit të pastrehë me qerradhënësin dhe rimbursohet ky i fundit nëpërmjet Drejtorisë së Financave dhe Degës së Thesarit, me numur llogarie të personit qerradhënës.

b-Njësia për Mbrojtjen e fëmijëve

Specialistja për mbrojtjen e fëmijëve organizon tryezën multidisciplinare për trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevoja emergjente me partnerë, Institucione dhe OJF.

Ngre dhe organizon rrjetin e skuadrave të terrenit të cilat konstatojnë rastet me fëmijë në situatë rruge, duke bërë edhe raportimin tre-mujor tek Agjensia për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe merr pjesë në tryezat antitrafik për fëmijët e rrezikuar. Merr

informacion nga të gjitha burimet e mundshme për fëmijë në nevojë duke ofruar shërbimet e disponueshme nga fondet e Bashkisë ose në bashkëpunim me partnerë të tryezës.

- Për fëmijët në arsim parashkollor me problem ekonomike, rekomandon në Këshill Bashkiak rastet që duhen trajtuar pa pagesë. – Për fëmijët e braktisur, në bazë të moshës, i propozon Këshillit Bashkiak strehimin në shtëpinë e foshnjës ose në qendra të tjera. -

- Për fëmijët në nevojë, në shkollat 9-vjeçare, i propozon Këshillit Bashkiak me fonde të Bashkisë blerjen e seteve shkollore dhe të një sasive librash edhe në bashkëpunim me OJF.

- Organizon Shkollën Verore për rreth 200 fëmijë gjatë muajit Korrik në bashkëpunim me OJF dhe me një fond nga Bashkia, të miratuar në çdo fillim viti nga K.B. –

Bashkëpunon në ngritjen dhe mbarëvajtjen e qendrave ditore për fëmijët e familjeve në nevojë (3 qendra), të moshës së tretë (4 qendra), të Qendrës multifunksionale për familjet e kthyer nga emigracioni. Këto qendra funksionojnë me shpenzime operative të mbuluara nga Bashkia (ose të ngritura në ambjente në pronësi të saj), të miratuara në çdo fillim viti nga Këshilli Bashkiak dhe menaxhohen me fonde dhe burime njerëzore të një organizate (Misioni Emanuel). Merr pjesë në të gjitha aktivitetet e organizuara dhe mban marrëdhënie me të gjitha institucionet dhe organizatat me fokus fëmijët dhe kujdesin ndaj tyre.

c- Koordinatorja e Qendrës komunitare.

Koordinatorja ka rol kryesisht mbështetës dhe konsultim-informim, mban lidhje dhe kontakte të vazhdueshme me organizatat dhe persona të komuniteteve kryesisht romë dhe egjiptiane. Qendra është ndërtuar në një nga ambjentet në pronësi të Bashkisë, me një financim të KE (zbatuese UNDP) dhe shpenzimet operative mbulohe nga Bashkia.

-Në bashkëpunim me partnerët, organizon tryeza informuese, takime këshilluese dhe orienton të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve në nevojë, për rrugët ligjore që duhet të ndjekin me qëllim përfitim të mbështetjes dhe shërbimeve të ofruara në mbështetje të tyre.

-Ndjek mbarëvajtjen e fëmijëve përfitues të Qendrave ditore .

-Kryen kontrole të vazhdueshme në terren me familjet e komuniteteve, duke ndjekur problematikat e tyre përfshirë edhe ato të shëndetit dhe higjenes.

-Kontrollon zbatimin e projekteve të ndryshme me qëllim eliminimin e elementëve të diskriminimit dhe segregimit.

-Organizon aktivitete si Dita ndërkombëtare e romëve, panairë për promovimin e vlerave të kulturës romë në bashkëpunim me shoqatat romë.

d-Zyra kundër dhunës në familje dhe për barazinë gjinore

Organizon dhe mban në funksion mekanizmin e reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje, mbledh një herë në vit Komitetin Kundër Dhunës në Familje dhe periodikisht ose edhe urgjent tryezën multidisiplinare me specialist të Institucioneve .

-Pret dhe dëgjon çdo rast dhune në familje, ka një nr. telefoni fiks pa pagesë në dispozicion të qytetarëve.

-Orienton për konsulencë dhe këshillim në bashkëpunim me specialistin përkatës.

-Ofron shërbim edhe në raport me gjykatën dhe psikologët, administron urdhrat e mbrojtjes, rekomandon për trajtim me pagesën e parashikuar, viktimat e dhunës të paisur me UM ose UMM.

- Menaxhon Qendrën për gratë e dhunuara “strehëzën”, e ngritur në një nga ambientet e Entit Kombëtar të Banesave me qerra (sociale) nga fondi i Bashkisë dhe menaxhim të brendshëm me specialist nga një prej organizatave bashkëpunëtoare.
- Raporton çdo muaj në MÇSR për situatën e dhunës në familje.
- Strehon në qendra sipas rasteve konkrete dhe specifikave gra apo pjesëtarë të familjes në risk të lartë dhe ndjek çështjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjes kur është e mundur.